



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.59/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryes, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbarueses private, znj. [Blank] si organ përmbarues e emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në Prizren, [Blank] dyshuar për shkelje disiplinore lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P. nr 25/19, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Znj. Fadilete Hoxha, me datën 28.01.2022, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

- I. Organi përmbarues - Përmbaruesja Private, znj. [Blank] është përgjegjëse për shkelje të disiplinore nga neni 367 par 1, pika 1.2, të LPP-së gjatë ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore në lëndën përmbarimore P. nr 25/19.
- II. Për kryerjen e kësaj vepre disiplinore, përmbarueses private, znj. [Blank], i shqiptohet masa disiplinore - Ndalimi i ushtrimit të profesionit e parapare me nenin 368 par 1, pika 1.4 të LPP-së, e cila sipas këtij aktvendimi vlen për periudhë tre (3) mujore duke filluar nga momenti kur ky vendim merr formën e prerë.

A R S Y E T I M

Me datën 06.12.2021, përkatësisht me dt 13.12.2021, përfaqësuesi i autorizuar i palës ankuese Av. [Blank] ka paraqitur ankesë në Departamentin për Profesione të Lira - Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat të Ministrisë e Drejtësisë, për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarueses privat znj. [Blank] si organ përmbarues e emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prizren. Sipas pretendimeve të palës ankuese, përmbaruesja private znj. [Blank] në çështjen përmbarimore P. nr 25/2019 ka ndërmarr veprime procedurale në kundërshtim me LPP-në dhe me shkelje të Kodit të Etikës duke keqpërdor detyrën zyrtare me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm. Pala ankuese pretendon që përmbaruesja privat znj. [Blank] me datën 23.01.2019 ka bllokuar llogaritë bankare të debitorit dhe pa e njoftuar debitorin ka ndërmarr veprime procedurale duke i pamundësuar parashtrimin e prapësimit.

Pala ankuese pretendon se asnjëherë nuk e ka pranuar Propozimin për përmbarim së bashku me Urdhrin për përmbarim. Megjithatë, pala ankuese thekson se përmbaruesja ka vazhduar me bllokimin e llogarive dhe veprimeve tjera përmbarimore. Pala ankuese thekson se debitori ka ushtruar kërkesë për kthimin në gjendjen e mëparshme dhe prapsim. Gjykata Themelore në - Departamenti Civil ka nxjerrë Aktvendimin PPP. Nr 276/2020 të datës 15.11.20221, me të cilin ka aprovuar prapësimin e debitorit z. për kthimin në gjendjen e mëparshme, gjithashtu ka aprovuar në tërësi prapësimin e debitorit duke shfuqizuar Urdhrin e Përmbarimit P. nr 25/19 të datës 23.01.2019 dhe e ka refuzuar të pa bazuar kërkesën e kreditorit. Sipas palës ankuese, përkundër njoftimit të përmbarueses private me aktvendim, e njëjta nuk ka bërë lirim të llogarive.

Me datën 13.12.2021, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lirë - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin Përfundimtar ndaj përmbarueses private znj. si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën P. nr 25/19.

Përmbaruesja private znj. në përgjigjen e saj me shkrim ka dorëzuar shkresat e lëndës P.nr 25/19, duke kërkuar refuzimin e ankesës si të pabazuar.

Me datën 28.01.2022, Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancë dëgjimore publike në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lirë - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, ndërsa pala ankuese dhe përfaqësuesi i palës ankuese z. dhe përmbaruesja private, znj. dhe përfaqësuesi i saj, edhe pse kanë qenë e njoftuar me rregull lidhur me seancën nuk janë paraqitur. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lirë - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbarueses private znj. duke theksuar se bazuar në ankesën e parashtruar nga pala ankuese përmbaruesja private znj. ka bërë shkelje disiplinore me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore në lëndën P.nr 25/19, duke shkelur ligjin dhe tejkaluar e saj autorizimet ligjore.

Gjatë seancës dëgjimore, Komisioni Disiplinor në cilësi të provave materiale ka administruar provat e paraqitura në raportin përfundimtar dt 13.12.2021, dhe gjithashtu provat e bashkangjitura në përgjigjen e përmbarueses private znj. Pas shqyrtimit me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese të çdo prove të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha atyre së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, Komisioni Disiplinor vjen në përfundim se përmbaruesja private znj. ka kryer dhe është përgjegjëse për veprimet disiplinore me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore lidhur me rastin përmbarimor P. 25/2019.

Komisioni Disiplinor gjen të rëndësishme të theksojë se në rastin konkret përmbarimi ishte lejuar sipas Urdhrit përmbarimor P. nr 25/19 dt 23.01.2019 mbi bazën e dokumentit përmbarimor - Marrëveshja mbi Pengun dhe Kredinë, nr B-31759 të datës 26.09.2008, në shumën e detyrimit prej 4,547.00 euro. Pala debitore - këtu ankuese pretendon të mos ketë pranuar urdhrin dhe, lidhur me të, thekson se ka kuptuar në momentin kur i është bllokuar llogaria bankare. Në anën tjetër, përmbaruesja private znj. në provat e bashkangjitura pretendon që Urdhri përmbarimor P. nr 25/19 dt 23.01.2019 ishte ekspeduar në mënyrë të rregullt dhe në pajtim me dispozitat ligjore. Komisioni Disiplinor vlerëson se çështja e dorëzimit të urdhrit përmbarimor,

megjithatë, ishte adresuar në gjykatën kompetente. Rrjedhimisht nuk është objekt shqyrtimi i kësaj procedure disiplinore. Ajo që përbën aspekt relevant në këtë procedure është fakti se Gjykata Themelore në ... – Departamenti Civil, me aktvendimin PPP. Nr 276/2020 dt 15.11.2021, kishte aprovuar kërkesën e palës debitore - këtu ankuesit për kthimin në gjendje të mëparshme ashtu që i kishte mundësuar palës debitore ushtrimin e mjetit juridik – prapësimin ndaj urdhrit përmbartimor. Neni 47 par 5, i LPP-së përcakton që “aktvendimi për përmbartim apo urdhri për përmbartim në llogari bankare i dërgohet bankës pasi që të bëhet i formës së prerë...” Në rastin konkret, fakti se Gjykata kishte aprovuar kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme nënkupton që Urdhri përmbartimor nuk ishte i formës së prerë sepse pala kishte ushtruar prapësim. Për më tepër, realisht, Gjykata me aktvendimin PPP. Nr 276/2020 të datës 15.11.2021, kishte aprovuar edhe prapësimin duke anuluar Urdhrin përmbartimor P. nr 25/19. Komisioni Disiplinor gjen se jo vetëm që Urdhri përmbartimor nuk ishte i formës së prerë por i njëjti faktikisht ishte anuluar nga ana e gjykatës. Rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor gjen se mbajtja e bllokuar e llogarisë bankare përkundër që Urdhri përmbartimor ishte anuluar nga gjykata përbën shkelje ligjore. Kjo sepse pala efektivisht ka të pamundur të operarohet për aq kohë sa llogaria bankare është e bllokuar. Nga shkresat e lëndës, përkatësisht korrespondenca elektronike e dt 17.11.2021, Komisioni Disiplinor konstaton që pala ankuese kishte njoftuar përmbartuesen privat znj. ... lidhur me aktvendimin e Gjykatës PPP. Nr 276/2020 të datës 15.11.2021 dhe kishte kërkuar lirimin e llogarisë. Përmbartuesja private znj. ... nuk kishte liru llogarinë përkundër që nuk kishte bazë të vlefshme juridike. Komisioni Disiplinor nuk gjen në rastin konkret asnjë arsye të vlefshme juridike që justifikonte mbajtjen të bllokuar nga ana e përmbartueses private të llogarisë bankare të palës ankuese. Vetëm pas fillimit të procedurës disiplinore pranë Komisionit Disiplinor dhe njoftimit të përmbartueses private znj. ... me dt 14.12.2021 për fillimin e procedurës disiplinore, e njëjta me datën 17.12.2021, nxjerr Urdhër për shfuqizimin e urdhrit përmbartimor dhe për lirimin e llogarisë bankare. Kjo, në vlerësimin e Komisionit Disiplinor, përbën shkelje disiplinore.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor kishte parasysh rrethanat e rastin konkret dhe veçanërisht faktin se ndaj përmbartueses private znj. ... është shqiptuar masë disiplinore vetëm disa muaj më parë për vepër të njëjtë apo të ngjashme disiplinore. Komisioni Disiplinor vlerëson se masa e shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbartueses, është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përmbartuesen si dhe tek përmbartuesit tjerë që t’u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbartimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, është edhe qëllimi i masës.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT
DPL.nr 59/2021, datë 28.01.2022

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

Faint, illegible text at the top of the page, possibly a header or title.

Main body of faint, illegible text, appearing to be several paragraphs of a document.

Second section of faint, illegible text, continuing the document's content.



Faint text located below the circular seal, possibly a signature or a reference number.